

KONCESIONE / PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës	Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Lunik”
Forma e kontratës	B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)
Burimi i financimit	Shoqëri tregtare private / Kapital privat
Vlera e parashikuar e projektit:	786,900,000 Leke (pa TVSH)
Kohëzgjatja e kontratës :	35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22 date 5.6.2017

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te ofruara:

1. Shoqëria “Restaurim Gurra – Kaca” sh.p.k. – Skualifikohet pasi ka dorëzuar vetëm Certifikatën e Regjistrimit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (NUIS) me nr. K87706601M dhe nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion tjetër te kërkuar nga shtojca nr. 9 te Dokumentave te Koncesionit.
2. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Fondi Erpa” sh.p.k. dhe “Osmani” sh.p.k. – Skualifikohet pasi nuk ka dorëzuar te gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe ne përputhje me kërkesat e parashikuara ne shtojcën nr. 9 te DSK, si dhe nuk përmbush kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe atë teknik sipas Dokumentave Standarte te Procedurës Konkurruese
3. Bashkimi i Përkohshëm te Shoqërive “Victoria Invest International” sh.p.k. dhe “Victoria Invest” sh.p.k.,
 - Fuqia e instaluar e percaktuar me prurjen llogaritese 7,000 kW
 - Prodhimi i energjise elektrike 26,500,000 kWh
 - Vlera e “Fee koncesionare” 2.5% (662,500 kWh)
 - Koha e zbatimit te punimeve 24 muaj
 - Kosto per njesi e makinerive dhe

Pajisjeve per kW fuqi te instaluar
Vlera e investimit (pa TVSH)

45,900 leke/kW
786,900,000 Leke

* * *

Ministria e Energjisë dhe Industrisë lajmëron **Z. Fatmir Kuçi**, Përfaqësues ligjor i shoqërisë “Victoria Invest International” sh.p.k., Përfaqësues i Bashkimit të Përkohshëm “Victoria Invest International” sh.p.k. dhe “Victoria Invest” sh.p.k. me adrese: Lagjja 28 Nëntori, Rruga 11 Nëntori, pranë Tatim – Taksave, Kati 2, Elbasan, se oferta e paraqitur më datë 30 Qershor 2017, për marrjen me koncesion të hidrocentralit “Lunik”, është pranuar.

Afati i negociimit të Kontratës tuaj do të jete brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit të fituesit.

Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive “Victoria Invest International” sh.p.k. dhe “Victoria Invest” sh.p.k. kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare/Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat Standarte të Procedurës Konkurruese, në vlerën e 10% të Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet të paraqitet jo me vone se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajnë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.7.2017

Ankesa: Nuk ka